



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE , MBROJTJE DHE SHPËTIM

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, NR.03/L-040, Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale ,të datës 28 shkurt 2018, Rregulloren për Shërbime Publike Komunale, të datës 06.08.2013, Drejtoria e Shërbimeve Publike , Mbrojtje dhe Shpëtim, shpall:

FTESË PUBLIKE APLIKIM PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

Njoftohen të gjithë pronarët e bizneseve, të cilët i shfrytëzojnë hapësirat publike për vendosjen e tavolinave shërbyese para lokaleve të tyre, dhe të gjithë të interesuarit e tjerë për shfrytëzim të përkoshëm të hapësirave publike në qytet, duke përfshirë edhe reklamat , të paraqesin kërkesën për marrje të lejeve në DSHPMSH.

Kërkesës i bashkangjitet :

- Certifikata e biznesit
- Skica me dimensionet e hapësirës për shfrytëzim
- Qëllimi dhe periudha e shfrytëzimit të hapësirës(shënohet në kërkesë)
- Kopja e leternjoftimit

I paralajmërojmë të gjithë shfrytëzuesit e hapësirave publike, se në rast të mospajisjes me leje komunale, në vazhdimësi do të ndërrmerren masa parandaluese dhe ndëshkimore ndaj tyre.

Afati për aplikim është deri më: 03.05.2024

Kërkesat dorëzohen në Administratën komunale, përkatësisht në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve.

Podujevë
17.04.2024



Drejtori
Bahri Selimi